



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORATI

Nr. 380 / Prot.  
11

Vlorë, më, 14.02.2024

VENDIM PROPOZUES

Nr.02, datë 14.02. 2024

**PËR MIRATIMIN E AMBJENTEVE TË NEVOJSHME PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË FAKULTETIN E SHËNDETIT NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, pika ç, të Statutit të UV-së, si dhe referuar shkresës së Administratorit me nr. 345, prot, datë, 12.02.2024, shkresës nr.89/1 prot, datë 17.01.2024 të Drejtorisë së Shërbimeve "Përcjellje informacioni mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të UV-së", shkresës nr.87/1 prot., datë 30.01.2024 "Përcjellje informacioni, mbi përputhshmërinë mes ambienteve të zhvillimit të mësimit me orarin mësimor faktik" Rektorati në mbledhjen e datës 14.02.2024

VENDOSI TË PROPOZOJË

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit, që për ambientet e zhvillimit të procesit mësimor të Fakultetit të Shëndetit, për periudhën Maj 2024-Maj 2025, të merren në konsideratë alternative të tjera, konform kuadrit ligjor, funksioneve dhe kompetencave të Administratorit dhe Bordit të Administrimit që ligji u njeh.  
Që prej vitit akademik 2018-2019 procesi mësimor i Fakultetit të Shëndetit është zhvilluar në ambiente të marra me qera, konform kërkesave buxhetore të FSH, të miratuara nga Rektorati, Senati Akademik si dhe nga Bordi Administrimit të UV-së.  
Ky propozim vjen në funksion të reduktimit të shpenzimeve financiare për këtë zë të buxhetit, ku Rektorati në mbledhjen e tij, konkludoi se: tre godinat në administrim të UV-së (Godina A,B,C) nuk ofrojnë mundësinë praktike që procesi mësimor i Fakultetit të Shëndetit (qoftë i pjesshëm, qoftë i plotë) të transferohet në godinat e mësipërme. Është jo efikase dhe e pamundur transferimi i laboratorëve, zyrave, dhe infrastruktura ekzistuese të vendosura deri tani në FSH.
2. Ky vendim propozues i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

